



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
V E N D I M

Nr.57, datë 01.06.2020

“PËR
PËRCAKTIMIN E MASËS SË VLERËS SË RIKONSTRUKSIONIT OSE RIPARIMIT DHE
MIRATIMIN E UDHËZUESIT “PËR DETAJIMIN E PROCEDURAVE PËR TË PËRFITUAR
NGA NËNPROGRAMI I GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30, shkronja “gj” dhe nenit 41, të Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, pikës 5, të Kreut IV, të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, Vendimit nr. 157, datë 27.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, memos me nr. 13946 prot, datë 28.04.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njërive Administrative dhe Emergjencave Civile, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit për përfitimin nga grantet e rikonstruksionit, për individët ose familjet, shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9/2019, në 70 % të vlerës së përcaktuar në kreun IV, pika 5, në shkronjën “a”, “b” dhe “c” të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar.
2. Miratimin dhe zbatimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e kontratës tip për përfitimin nga grantet e rikonstruksionit për individët ose familjet, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësitë Administrative/Lagjet për lëshimin e akteve të nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, ngarkohen për nënshkrimin e kontratës përkatëse të grantit, për përfituesit e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.
7. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU